




1266  
01.10.2020



3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 4526/11 Prot

Elbasan më 30 /09/2020

**VENDIM**

Nr 117 datë 30/09/2020.

**Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin GUSHT 2020**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 3 datë 27.01.2020 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë”


**VENDOSI**

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të bashkisë për muajin GUSHT 100 familje me fond 278.100 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak  
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak  
Hektor Çiftja





2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 4524 / Prot  
11

Elbasan më 30 /09/ 2020

VENDIM

Nr. 118 datë 30 /09/2020

**Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin GUSHT 2020**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 4 datë 27.01.2020 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”

V E N D O S I

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin **GUSHT 2020** gjithsej 137 familje me një fond prej 453.836 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak  
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak  
Hektor Ciftja





1268

01.10.2020



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA ELBASAN  
KESHILLI BASHKIAK

Nr. ~~4528~~ / prot

Elbasan me 30.09.2020

V E N D I M

Nr. 19 / datë 30 / 09 / 2019

Për vendosjen në institucionet rezidenciale të shërbimeve sociale.

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 30 / 09 / 2020 pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social e Komunitar dhe vendimin e "Komisionit të vlerësimit të nevojave dhe vendosjes në institucionet rezidenciale të shërbimeve sociale dhe kujdestarisë", bazuar në ligjin nr.121/206 datë 24.11.2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në R.Sh.", neni 28 dhe VKM nr.518 datë 04.09.2018 "Për përcaktimin e kritereve dhe dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale publike dhe jopublike të përkujdesit shoqëror",

V E N D O S I

I. Të miratojë vendosjen në Qendrën Sociale Balashe si më poshtë:

1. I moshuari Z. Nikolla Llazi Pallashi, i datëlindjes 28.07.1944, banuese në lagjen "Brig.17 S" të qytetit të Elbasanit .

II. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar si dhe Drejtoria e Qendres Sociale Balashe.

III. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak

Hektor Çiftja



1269  
01.10.2020



3

4

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4329/11 Prot.

Elbasan më, 30.09.2020

**V E N D I M**

Nr. 120 Datë: 30.09.2020

**“Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga tërmeti në banesën e Z. Shefqet Ramazan Qosja, banor në Fshatin Shingjin, Njësia Administrative Gracen si dhe dëmshpërblimin financiar”.**

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 30.09.2020, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Financës “Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga tërmeti në banesën e shtetasit **Z. Shefqet Ramazan Qosja**, banor në Fshatin Shingjin, Njësia Administrative Gracen si dhe dëmshpërblimin financiar”, bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligjin 45/2019 “Për mbrojtjen civile”;
- VKM nr.329 datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”;
- VKB Nr. 252. datë 24.12.2019 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2020”;

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Elbasan.
2. Të miratojë vlerën e dëmshpërblimit financiar bazuar në V.K.M. Nr. 329 datë 16.5.2012 e cila është **50%** të vlerës së preventivit të përlogarit bazuar në dëmet e shkaktuara nga tërmeti në banesë, d.m.th.  $2\ 410\ 443 \times 50\% = 1\ 205\ 221$  lekë, pra vlera e dëmshpërblimit për shtetasin **Z. Shefqet Ramazan Qosja** është në **1 205 221** (një milion e dyqind e pesë mijë e dyqind e njëzet e një ) lekë.
3. Ti paraqesë dokumentacionin përkatës dhe ti kërkoj mbështetje financiare Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Ministrisë së Mbrojtjes, për akordimin e dëmshpërblimit prej **1 205 221** (një milion e dyqind e pesë mijë e dyqind e njëzet e një ) lekë, për shtetasin **Z. Shefqet Ramazan Qosja**.

5

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore ( Drejtoria e Emergjencave Civile ).
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**

**Klajd Gripshi**



**KRYETARI**

**Hektor Çiftja**



1270  
01.10.2020



3/1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4530/Prot.  
11

Elbasan më, 30.09.2020

V E N D I M

Nr. 121 Datë: 30.09.2020

**“Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga tërmeti në banesën e Z.Elmaz Livan Kalia, banor në Lagjen “Dyli Haxhire”, Rruga “Maliq Bej Riza”, Lagjia Nr. 3 si dhe dëmshpërblimin financiar”.**

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 30.09.2020, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtorja e Emergjencave Civile dhe Drejtorja e Financës “Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga tërmeti në banesën e shtetasit **Z.Elmaz Livan Kalia**, banor në Lagjen “Dyli Haxhire”, Rruga “Maliq Bej Riza”, Lagjia Nr. 3 si dhe dëmshpërblimin financiar”, bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligjin 45/2019 “Për mbrojtjen civile”;
- VKM nr.329 datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”;
- VKB Nr. 252. datë 24.12.2019 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2020”;

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Elbasan.
2. Të miratojë vlerën e dëmshpërblimit financiar bazuar në V.K.M. Nr. 329 datë 16.5.2012 e cila është **50%** të vlerës së preventivit të përlllogaritur bazuar në dëmet e shkaktuara nga tërmeti në banesë, d.m.th.  $770\ 455 \times 50\% = 385\ 227$  lekë, pra vlera e dëmshpërblimit për shtetasin **Z. Elmaz Livan Kalia** është në **385 227** (treqind e tetëdhjetë e pesëmijë e dyqind e njëzet e shtatë ) lekë.
3. Ti paraqesë dokumentacionin përkatës dhe ti kërkoj mbështetje financiare Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Ministrisë së Mbrojtjes, për akordimin e dëmshpërblimit prej **385 227** ( treqind e tetëdhjetë e pesëmijë e dyqind e njëzet e shtatë ) lekë, për shtetasin **Z. Elmaz Livan Kalia**.

4

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore ( Drejtoria e Emergjencave Civile ).
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**

**Klajd Gripshi**



**KRYETARI**

**Hektor Çiftja**



1271  
01.10.2020



2/2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4531/Prot.  
11

Elbasan më, 30.09.2020

VENDIM

Nr. 122 Datë: 30.09.2020

**Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së Z.Xhevit Xhetan Kazani, banor në Lagjen "Emin Matraxhiu", Rruga "Koço Brisku", Lagjja Nr. 1, Elbasan si dhe shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Elbasan**

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 30.09.2020, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Financës "Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së shtetasit **Z. Xhevit Xhetan Kazani**, banor në Lagjen "Emin Matraxhiu", Rruga "Koço Brisku", Lagjja Nr. 1, Elbasan, si dhe shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Elbasan", bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligjin 45/2019 "Për mbrojtjen civile";
- VKM nr.329 datë 16.5.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore";
- VKB Nr. 252. datë 24.12.2019 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2020";

**VENDOSI:**

1. Miratimin e dokumentacionit tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Elbasan.
2. Të miratojë vlerën financiare të dëmshpërblimit, për dëmin e shkaktuar nga djegia në banesën e shtetasit **Z. Xhevit Xhetan Kazani** është në **400 961** ( katërqind mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e një ) **lekë**. Kjo vlerë është rezultat i **50%** të vlerës së preventivit të dëmeve në banesë të hartuar nga ekspertët + vlerën e preventivit në pajisje dhe orendi, d.m.th.  $549\ 923 \times 50\% = 274\ 961\ \text{lekë} + 126\ 000\ \text{lekë} = 400\ 961\ \text{lekë}$ .
3. Të miratojë dhënien e ndihmës financiare nga Bashkia Elbasan, në shumën prej **400 961** ( katërqind mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e një ) **lekë**, për familjen e **Z.Xhevit Xhetan Kazani**.



4

4. Efekti financiar, për pikën 3 të këtij vendimi, do të përballohet nga Fondi i Emergjencave Civile, i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Elbasan për vitin 2020, të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak VKB Nr. 252. datë 24.12.2019.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore ( Drejtoria e Emergjencave Civile ).
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**

**Klajd Gripshi**



**KRYETARI**

**Hektor Çiftja**





1272

01.10.2020



4 21



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4582 / Prot.Datë 30 .09. 2020

VENDIM

NR. 123 DATË 30 .09. 2020

MBI

**“Rishpërndarje fonde në buxhetin e vitit 2020, nga granti dhe nga të ardhurat”,**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 30 .09. 2020, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi “Rishpërndarje fonde në buxhetin e vitit 2020, nga granti dhe nga të ardhurat”, bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, udhëzimin nr.2, datë 20.01.2020 të Ministrisë së Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020” dhe vendimin e Këshillit Bashkiak nr.201, datë 24.12.2019 mbi “Miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2020”, i ndryshuar,

VENDOSI :

1. Rishpërndarjen e fondeve në buxhetin e vitit 2020, nga granti dhe të ardhurat, për Bashkinë dhe njësitë vartëse, si më poshtë :

**Paksohet :**

- 4,000 mijë lekë, “Sistemim asfaltim vazhdim i rrugës "17 Marsi" + rruga "Xhaferr Miraku", (diferencë objekti + superviz.+ kolaud.) kapitulli 5, Bashkia;
  - 5,700 mijë lekë, “Rikonstruksion i qendrave të Nj.Ad.Gjinar, Tregan, Labinot Mal”, (diferencë nga objekti ), kapitulli 1, Bashkia;
  - 7,000 mijë lekë , “Blerje barriera (FV) të sigurisë për hapësirat publike (+elementë për lodrat)”, kapitulli 1, ASHP;
  - 4,669 mijë lekë, “Rikonstruks. i rrugës "Abdyl Kajanaku", Lagjja "Brigada 17 Sulmuese" (tepricë nga prokurimi), kap. 5, Bashkia;
  - 250 mijë lekë, shpenzime (art.602), kap. 5, Trash.Kulturore,
  - 7,000 mijë lekë, Projekte për zhvillimin dhe promovimin e biznesit”, art.604, Bashkia.
- 28,619 mijë lekë gjithsej**

**Shtohet :**

- 2,583 mijë lekë, shtese fondi “Rehabilitim sheshit para pallatit 108/1 (lulishte midis rrugëve Q.Stafa dhe unazës perëndimore)”, Bashkia;
  - 7,054 mijë lekë, shtese fondi “Rikonstruksion i rrugës "Jani Maçolli", Bashkia;
  - 13,700 mijë lekë, “Rikonstruksion i gjendjes egzistuese të rrugës “Kisha Shën Thanasit”, në Lagjen “Aqif Pasha”, Bashkia;
  - 564 mijë lekë, “Restaurim i pjesshëm i ambienteve të brëndshme të SHMZSH Elbasan” ;
  - 620 mijë lekë “Blerje pajisje për ndërhyrje në raste aksidentesh (prerëse,shtyrëse,hapëse) + gjenarator (1)”, art.231, SHMZSH,
  - 3,000 mijë lekë, shpenzime projekti ReLOaD , artikulli 604, Bashkia,;
  - 120 mijë lekë, “Blerje qilim + rrugicë për Muzeun Etnografik”, artikulli 231, Tr.Kult.
  - 119 mijë lekë “Sistemi kamerave në Muzeut Etnografik”, artikulli 231, Tr.Kulturore;
  - 330 mijë lekë, “Ndërtimin i një segmenti të linjes KUZ, Lagja “ Maji”, Art.231, Bashkia;
  - 482 mijë lekë, supervizim “Rikonstruksion dhe adoptim i mjediseve të Qend. Kulturore të Fëmijëve në Qendër Rinore”, Bashkia (obj.financ. buxheti shtetit)
  - 47 mijë lekë, kolaudim “ “ “ “
- 28,619 mijë lekë gjithsej**

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Prokurimeve, SHMZSH dhe Trashegimia Kulturore,
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

**SEKRETAR**  
**Klajd Gripshi**



**KRYETAR**  
**Hektor Ciftja**





1273

01.10.2020



4



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4533/ Prot.

Datë 30 .09. 2020

## VENDIM

NR. 124 DATË 30 .09. 2020

## MBI

“Mbi shtimin e numrit të punonjësve në arsimin parashkollor për një periudhë 6-mujore”.

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 30 .09. 2020, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria e Administratës dhe Burimeve Njerëzore mbi “Mbi shtimin e numrit të punonjësve në arsimin parashkollor për një periudhë 6-mujore”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”,

## VENDOSI :

1. Miratimin e shtimit të numrit të punonjësve në sistemin e arsimit parashkollor, përkatësisht 15 punonjësve sanitare si dhe 4 punonjës për dezinfektimin e objekteve arsimore. për një periudhë 6 mujore , me qëllim përmirësimin e situatës së pandemisë së shkaktuar nga covid-19.
2. Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore për këta punonjës, për vitin 2020 (periudha tetor-nëntor) do të përballohet nga fondi i miratuar në buxhetin e vitit 2020 për Qendrën Ekonomike të Arsimit. Periudha e mbetur do të parashikohet në buxhetin e vitit 2021.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Administratës dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Buxhetit dhe Qendra Ekonomike e Arsimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

SEKRETAR  
Klajd Gripshi

KRYETAR  
Hektor Ciftja





1274

01.10.2020



6 24

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4558/ Prot.

Elbasan, më 30.9.2020

VENDIM

Nr. 125 datë 30.9.2020

*“Mbi miratimin në parim të fillimit të procedurave për dhënien me konçension / partneritet publik privat të projektit "Rikualifikimi urban i infrastrukturës rrugore dhe rekreativiteti i blloqeve të banimit, në disa lagje të qytetit të Elbasanit", si propozim i kërkuar”*

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 30.9.2020, me propozim të Kryetarit të Bashkisë dhe relacionit të paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Projekteve “Mbi miratimin në parim të fillimit të procedurave për dhënien me konçension / partneritet publik privat të projektit "Rikualifikimi urban i infrastrukturës rrugore dhe rekreativiteti i blloqeve të banimit, në disa lagje të qytetit të Elbasanit", si propozim i kërkuar”, mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar) dhe në ligjin nr.125/2013 "Për konçensionet dhe partneritetin publik privat" (i ndryshuar);

VENDOSI:

1. Të miratojë në parim fillimin e procedurave për dhënien me konçension / partneritet publik privat të projektit “Rikualifikimi urban i infrastrukturës rrugore dhe rekreativiteti i blloqeve të banimit, në disa lagje të qytetit të Elbasanit”, si propozim i kërkuar, në zonat dhe blloqet e banimit të identifikuara nga administrata e Bashkisë, të prezantuara në relacionin e paraqitur, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.


SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Hektor Çiftja





REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA ELBASAN  
KESHILLI BASHKIAK

Nr. 4555/prot  
/

Elbasan me 30.09.2020

V E N D I M

Nr. 126 /datë 30/09/2019

**“Mbi miratimin e pranimit pa pagesë në shërbimin e çerdheve dhe kopështeve publike për fëmijët 0-3 vjeç, të grave viktime të dhunës në familje të pajisura me urdhër mbrojtje nga Gjykata për kohëzgjatjen e urdhërit të mbrojtjes”.**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 30/09/2020 pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social e Komunitar, bazuar në nenin 144 të Kodit të Procedurave Administrative, në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në ligjin nr. 121/2006 datë 24.11.2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në R.Sh.”, në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i ndryshuar,

V E N D O S I

I. Të miratojë pranimin pa pagesë në shërbimin e çerdheve dhe kopështeve publike për fëmijët 0-6 vjeç, të grave viktime të dhunës në familje, të pajisura me urdhër mbrojtje nga Gjykata, për kohëzgjatjen e urdhërit të mbrojtjes.

II. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar si dhe Drejtoria e Qendres Ekonomike te Arsimit.

III. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

**Sekretar i Këshillit Bashkiak**

**Klajd Gripshi**

**Kryetari i Këshillit Bashkiak**

**Hektor Çiftja**





1276  
01.10.2020

8  
3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4561/Prot.

Elbasan, më 30.09.2020

V E N D I M

Nr. 127 Datë: 30.09.2019

***“Mbi dhënie me qira (rinovim kontrate) të ambjentit “kuzhinë” në konviktin e shkollës së mesme profesionale “Luigj Gurakuqi”***

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 30.09.2020 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve Buxhetit dhe Financës, (sektori i pronave) bazuar në ligjin Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, V.K.M Nr. 416 datë 11.07.2007 “Për miratimin e listës përfundimtare të Pronave të Paluajtshme të Shtetit që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Elbasan”, V.K.M Nr. 54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozoë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore”, i ndryshuar, V.K.B Nr. 24 datë 24.02.2009 “Mbi miratimin e tarifave të dhënies së ambjenteve me qira nga Bashkia Elbasan”,

V E N D O S I :

1. Miraton dhënien me qira (rinovim kontrate) të ambjentit “kuzhinë” të konviktit të shkollës së mesme profesionale “Luigj Gurakuqi” me nr. pasurie 7/93 ndodhur në Lagjen “Luigj Gurakuqi”, Z.K.8521 me sipërfaqe 153 m<sup>2</sup>, për t’u përdorur për “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për nxënësit e konviktit të shkollës së mesme profesionale” (Katering) të Bashkisë Elbasan, me tarifë qiraje mujore 200 (dyqind) lekë/m<sup>2</sup>, subjektit “Olta Sharra” me afat 3 (tre) muaj nga data 01.10.2020 deri më 24.12.2020.
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve Buxhetit dhe Financës, (sektori i pronave), Drejtoria Buxhetit dhe Drejtoria Financës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

SEKRETAR  
Klajd Gripshi





1277  
01.10.2020



9

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. ~~4558~~ Prot.

Elbasan, më 30.09.2020

V E N D I M

Nr. 128 Datë: 30.09.2020

*“Mbi miratimin e fillimit të procedurave për kërkimin e kalimit në pronësi të Bashkisë Elbasan, të dy pasurive ndodhur në Z.K. 8524 dhe Z.K 8521”.*

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 30.09.2020, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Administrata e Bashkisë “Mbi miratimin e fillimit të procedurave për kërkimin e kalimit në pronësi të Bashkisë Elbasan, të dy pasurive ndodhur në Z.K. 8524 dhe Z.K 8521”, bazuar në ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin Nr. 8744, datë 22.01.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësinë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar;

V E N D O S I:

1. Miraton fillimin e procedurave për kërkimin e kalimit në pronësi të Bashkisë Elbasan, me qëllim zhvillimin ekonomik e social-kulturor të qytetit të Elbasanit për pasuritë:
  - a). “Ish-Drejtoria Arsimore Elbasan” ndodhur në Z.K 8524 lagja “Kala”.
  - b). “Ish Zyrat e Shërbimit Kombëtar të Punësimit Elbasan” ndodhur në Z.K 8521 lagja “Kongresi Elbasanit”.
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata e Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI  
Klajd Gripshi



KRYETARI  
Hektor Çiftja





1278

01.10.2020



10

2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4560 / Prot.Elbasan, më 30.09.2020

V E N D I M

Nr. 129 Datë: 30.09.2020

*“Mbi miratimin e fillimit të procedurave për kërkimin e kalimit në pronësi të Bashkisë Elbasan, të pasurive “A” dhe “B” ndodhur në Z.K. 8523”.*

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 30.09.2020, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Administrata e Bashkisë “Mbi miratimin e fillimit të procedurave për kërkimin e kalimit në pronësi të Bashkisë Elbasan, të dy pasurive”, bazuar në ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin Nr. 8744, datë 22.01.2001 “Për transferimin e pronave të paluajsihsme të shtetit në njësinë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar;

V E N D O S I:

1. Miraton fillimin e procedurave për kërkimin e kalimit në pronësi të Bashkisë Elbasan, për dy pasuri të pozicionuara në zonën Jug-Perëndimore të qytetit, anën Jugore të unazës “Çerçiz Topulli”, pranë stacionit të trenit, me qëllim zbatimin e projektit për vendqëndrimin e mjeteve të transportit publik dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit për qytetarët, me të dhënat si më poshtë:
  - a) Pasuria “A” me sipërfaqe 1255.4 m<sup>2</sup> ndodhur në Z.K 8523 (nga kjo dy objekte, 909.7 m<sup>2</sup> dhe 134.9 m<sup>2</sup>).
  - b) Pasuria “B” me sipërfaqe 2194.0 m<sup>2</sup> ndodhur në Z.K 8523.
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata e Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI  
Klajd Gripshi



KRYETARI  
Hektor Çiftja

1279

01.10.2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË ELBASAN

Nr. 4557 Prot

Elbasan, më 30.09.2020

VENDIM

Nr. 130 datë 30.09.2020

“PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUTIT TË SHOQËRISË AKSIONARE  
“TRAJTIMI I STUDENTËVE” SH.A., ELBASAN”

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 9, pika 1.2.(c), nenit 33, pika 1(d) dhe nenit 54, pika (d) të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, të nenit 135, pika 2(b) të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, si dhe të VKM Nr.364, datë 06.05.2020 “Për transferimin e pronësisë së 100% të aksioneve të shoqërisë “Trajtimi i studentëve” sh.a., Elbasan, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë të Bashkia Elbasan”, Këshilli i Bashkisë Elbasan, si organi përfaqësues i personit juridik publik, Bashkia Elbasan, në cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë “Trajtimi i studentëve” sh.a., Elbasan, në mbledhjen e tij të datës 30.09.2020, pasi mori në shqyrtim propozimin e e administratës të Bashkisë Elbasan,

VENDOSI

VENDOSI

1. Të miratojë ndryshimin e Statutit (Statutin e ri) të shoqërisë aksionare “Trajtimi i studentëve” sh.a., Elbasan.
2. Statuti i shoqërisë aksionare “Trajtimi i studentëve” sh.a., Elbasan, të jetë ai bashkëngjitur këtij vendimi.
3. Ky vendim të regjistrohet në QKB, si dhe në regjistrin e veçantë të vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë “Trajtimi i studentëve” sh.a., Elbasan

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Hektor Çiftja





REPubLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN

1280  
01.10.2020  
12  
2  
Nr. 4556/Prot  
11

Elbasan, më 30.09.2020

VENDIM

Nr. 131 datë 30/09/2020

**“Për Autorizim për përfaqësimin e Aksionarit të vetëm, në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, të shoqërisë Shoqërisë “Trajtimi i studentëve” sh.a., Elbasan”**

Në mbështetje të nenit 54, pika (k) të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, të nenit 135, pika 4 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, të VKM Nr.364, datë 06.05.2020 “Për transferimin e pronësisë së 100% të aksioneve të shoqërisë “Trajtimi i studentëve” sh.a., Elbasan, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë të Bashkia Elbasan”, si dhe të nenit 8, pika 3 të Statutit të shoqërisë “Trajtimi i studentëve” sh.a., Elbasan, Këshilli i Bashkisë Elbasan, si organi përfaqësues i personit juridik publik, Bashkia Elbasan, në cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë “Trajtimi i studentëve” sh.a., Elbasan, në mbledhjen e tij të datës 30.09.2020, pasi mori në shqyrtim propozimin e e administratës të Bashkisë Elbasan,

**VENDOSI:**

1. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Elbasan, z.Gledian Llatja, të përfaqësojë personin juridik Bashkia Elbasan, si Aksionar të vetëm të shoqërisë “Trajtimi i studentëve” sh.a., Elbasan, në të gjitha mbledhjet që do të zhvillojë Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë “Trajtimi i studentëve” sh.a., Elbasan, gjatë gjithë periudhës së mandatit të Këshillit të Bashkisë Elbasan.
2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Elbasan dhe Administratori i shoqërisë “Trajtimi i studentëve” sh.a., Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI**

Klajd Gripshi  
CAN

**KRYETARI**

Hektor Çiftja  
21/10





1281  
01.10.2020



3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4566/Prot  
11

Elbasan, më 30.09.2020

VENDIM

Nr. 132 datë 30.09.2020

“ Për një ndryshim në VKB nr.6 datë 27.01.2020 “Për miratimin e normave dhe kritereve, për disiplinimin e shpenzimeve për mjetet motorike në administrim të Agjensinë SË Shërbimeve Publike Elbasan për vitin 2020 “

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 54, të ligjit nr.115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pasi mori në shqyrtim propozimin e Agjensisë së Shërbimeve Publike, në mbledhjen e tij të datës 30/09/2020 të Bashkisë Elbasan,

**VENDOSI:**

1. Të miratoj një shtesë në VKB nr.6 datë 27.01.2020 “Për miratimin e normave dhe kritereve për disiplinimin e shpenzimeve për mjetet motorike në administrim të Agjensinë e Shërbimeve Publike Elbasan për vitin 2020 “ sipas tabelës bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Agjensia e Shërbimeve Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI**

Klajd Gripshi

**KRYETARI**

Hektor Çiftja





1282

01.10.2020



36



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 155 / Prot.Datë 30 .09. 2020

## VENDIM

NR. 133 DATË 30 . 09. 2020

## MBI

## “Raporti i monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e dytë të vitit 2020”

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 30 .05.2020, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi “Raporti i monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e dytë të vitit 2020”, bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48, pika 1, udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.22, date 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisve të vetëqeverisjes vendore”,

## VENDOSI

1. Të miratoje “Raportin e monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e dytë të vitit 2020”, për Bashkinë Elbasan, sipas materialit bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata e Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.

SEKRETAR  
Klajd Gripshi

KRYETAR  
Hektor Çiftja

